

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ÇUPI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 27187/08)

VENDIM

STRASBURG

14 nëntor 2023

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Çupi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke marrë në konsideratë:

kërkesën (nr. 27187/08) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 6 qershor 2008, nga një shtetas shqiptar, Fatmir Çupi, lindur në vitin 1986 në Mirditë ("kërkuesi"), i cili u përfaqësua nga z. S. Zeqiri, një avokat që e praktikon ligjin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare ("qeveria") në lidhje me ankesat depozituar në mbështetje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës. Fillimisht, qeveria u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. A. Hiçka, dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 17 tetor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkuesi u ankua në mbështetje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës se ishte shpallur fajtor në mbështetje të deklaramëve të dhëna pa avokat.

I. RRETHANAT E VRASJES MË 9 QERSHOR 2004

2. Më 3 qershor 2004, kërkuesi, kushëriri i tij E., dhe një shok B., u fshehën në periferi të Kaçinarit.

3. Më 5 dhe 6 qershor 2004, ata qëndruan me një familjar të E-së, dhe ndanë një dhomë me djalin shtatëmbëdhjetëvjeçar të familjes, F. Ata ishin të armatosur dhe në mbrëmjen e datës 5 qershor 2004, F. dëgjoi kërkuesin dhe E. teksa po bisedonin për të vrarë "të vjetrin" dhe "të riun". Sipas deklaramëve të bëra më pas nga F. (shih paragrafin 9 në vijim), kërkuesi shprehu mbështetjen e tij ndaj E. për të realizuar planin.

4. Më 6 qershor 2004, shoku pesëmbëdhjetëvjeçar i F., Gj., vizitoi ambientet ku ata po qëndronin dhe dëgjoi E. teksa po fliste për të "asgjësuar" oficerin e policisë së zonës. Gjatë atij diskutimi, kërkuesi kishte pohuar me kokë në shenjë miratimi dhe kishte pohuar se ishte me E. në të gjitha veprimet e tij.

5. Më 9 qershor 2004, B. kishte dalë për të blerë ushqime dhe kishte parë oficerin e policisë në fjalë. B. informoi E.-në dhe kërkuesin për këtë gjë, dhe kërkuesi i kishte thënë E.-së: "Lëre, mos shko". Megjithatë, E. kishte dalë vetëm për të kërkuar oficerin e policisë dhe më pas, kishte

qëlluar me armë si oficerin e policisë edhe djalin e tij. Pasi E. ishte kthyer në shtëpi, të tre ishin larguar në male.

II. HETIMI PENAL

6. Më 27 qershor 2004, kërkuesi u vetëdorëzua dhe u mbajt në paraburgim. Në të njëjtën datë, ai dha deklaratat për policinë në cilësinë e personit të akuzuar për vrasje të rëndë, në mungesë të një avokati. Në pjesën hyrëse të procesverbalit të marrjes së tij në pyetje deklarohet se kërkuesi kishte përfunduar arsimin e detyruar tetëvjeçar dhe ishte i papunë. Në pjesën e procesverbalit në lidhje me praninë e avokatit deklarohet se:

“[Oficeri i policisë:] Akuzoheni për vrasje të rëndë dhe mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit dhe [se jeni informuar], në mbështetje të nenit 158 të KPP [Kodit të Procedurës Penale] [sipas së cili pjesëtarët e familjes së të akuzuarit përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar], për të drejtën tuaj për të dhënë shpjegime ose për të mos e bërë një gjë të tillë. A dëshironi të përfitoni nga kjo e drejtë dhe [e drejta] për një avokat?”

[Kërkuesi]: Unë nuk kam një avokat dhe do të flas me babanë tim më vonë për të parë nëse ai mund të më sigurojë një avokat. Në lidhje me pyetjen drejtuar nga ju, e kuptoj dhe deklaroj se jam dakord që të jap shpjegime tani.”

7. Kërkuesi bëri përpara oficerëve të policisë një rrëfim të detajuar të aktiviteteve të tij me E. si përpara edhe pas vrasjes. Ai deklaroi se disa ditë përpara vrasjes, me frikën se oficeri i policisë në fjalë po i kërkonte, ata ishin larguar për t’u fshehur. Në datën konkrete, E. ishte informuar nga B. se oficeri i policisë ishte afër. Më pas, E. kishte shkuar vetëm për të kërkuar oficerin dhe kishte qëlluar me armë si oficerin edhe djalin e tij. Në fund, kërkuesi bënte një përshtkrim të detajuar për mënyrën se si kishin mbijetuar në male pas vrasjes.

8. Më 28 qershor 2004, E. deklaroi përpara oficerëve të policisë se kërkuesi kishte miratuar idenë për të vrarë oficerin e policisë dhe kishte shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në vrasje. Gjithashtu, E. tha se në datën konkrete, kërkuesi i kishte thënë: “Lëre, mos shko” (shih paragrafin 5 më sipër).

9. Më 14 korrik 2004, F. dhe Gj. kishin dhënë deklaratat për policinë, ku kishin përshtkruar ngjarjet siç detajohen në paragrafët 3 dhe 4 më sipër.

III. PROCESI GJYQËSOR

10. Në një datë të papërcaktuar, z. S. Zeqiri, i cili përfaqëson kërkuesin në Gjykatë, pranoi të përfaqësonte kërkuesin në procesin vendas. Rezulton se për shkak të situatës së dobët financiare të kërkuesit, përfaqësuesi nuk kërkoi parapagim (shih paragrafin 53 në vijim). Gjithashtu, palët nuk nënshkruan as ndonjë marrëveshje me shkrim për tarifat.

11. Më 8 nëntor 2004, prokurori dërgoi kërkuesin E. dhe B. për gjykim në Gjykatën e Rrethit të Krimeve të Rënda (“Gjykata e Rrethit”). Sipas nenit 79 §§ (a) dhe (c) të Kodit Penal (shih paragrafin 22 në vijim), kërkuesi u akuzua për mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit dhe vrasje të rëndë të një minoreni dhe një oficeri policie.

12. Gjykata e Rrethit dëgjoi një sërë dëshmitarësh, duke përfshirë F. dhe Gj., të cilët dëshmuuan se kishin dëgjuar tre të akuzuarit teksa diskutonin se si do të zgjidhnin një çështje të mbetur pezull me një oficer policie. Gjykata plotësoi kërkesën e bërë nga prokurori për leximin në gjykatë të deklaratave të dëshmitarëve të mitur të datës 14 korrik 2004, dhe i përfshiu ato në dosjen e çështjes në funksion të plotësimit të dëshmitave tyre në gjykatë.

13. Kërkuesi i kërkoi gjykatës të hiqte nga dosja e çështjes deklaratat e tij të datës 27 qershor 2004 të bëra në mungesë të një avokati (shih paragrafët 6 dhe 7 më sipër). Gjykata e rrëzoi kërkesën, duke konstatuar se ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për një avokat. Gjithashtu, gjykata vlerësoi se deklaratat e bëra nga kërkuesi gjatë hetimit duhej të përfshiheshin në dosjen e çështjes për të kundërshtuar dëshminë e kërkuesit dhënë përpara gjykatës.

14. Gjithashtu, gjykata pranoi një deklaratë të dhënë nga E. më 28 qershor 2004 (shih paragrafin 8 më sipër).

15. Kërkuesi nuk e pranoi akuzën për vrasje dhe pretendoi se ajo duhej të riklasifikohej si “moskallëzim i një krimi” dhe “mbështetje dhënë një krimineli”.

16. Më 7 tetor 2005, Gjykata e Rrethit e shpalli kërkuetin fajtor për akuzën e vendosur ndaj tij dhe e dënoi me njëzet e pesë vite burgim. Gjykata pohoi se edhe pse kërkueti nuk kishte marrë pjesë në kryerjen e vrasjes, ndihma e tij, duke qenë i pranishëm, duke shoqëruar dhe ofruar ndihmë dhe këshilla i kishte dhënë E.-së kurajën dhe besimin për të kryer veprën penale. Gjithashtu, ajo gjykoi se dëshmia e të miturve gjatë gjykimit duhej të analizohet në lidhje me deklaratat e bëra më 14 korrik 2004 gjatë hetimit (shih paragrafët 9 dhe 12 më sipër). Sipas të dhënave dhe deklaratave të E.-së gjatë hetimit, gjykata arrin në përfundimin se bashkëbisedimet e kërkuetit me E. demonstroi se ai kishte bërë një marrëveshje të qartë për të ndihmuar në vrasjen e oficerit të policisë dhe të fëmijës së tij. Në fund, gjykata arriti në përfundimin se disa zhvillime të caktuara ishin provuar me anë të një sërë burimesh, duke përfshirë edhe deklaratën e vet kërkuetit të datës 27 qershor 2004.

17. Kërkueti apeloj duke argumentuar, midis të tjerash, se më 27 qershor 2004 ai ishte marrë në pyetje pa praninë e një avokati.

18. Më 29 dhjetor 2005, Gjykata e Krimeve të Rënda e Apelit (“Gjykata e Apelit”) la në fuqi masën për dënimin e kërkuetit, por e uli dënimin në njëzet e dy vite burgim. Në lidhje me argumentet e kërkuetit, gjykata theksoi se kërkueti kishte pranuar të pyetet në mungesë të një avokati dhe se deklarata e tij ishte shqyrtuar duke marrë në konsideratë prova të tjera në dosjen e çështjes. Gjithashtu, ajo gjykoi se deklaratat e të miturve, të datës 14 korrik 2004, ishin marrë në mbështetje të ligjit vendas.

19. Më 15 nëntor 2006, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, ajo e uli vendimin e kërkuetit në njëzet vite burgim.

20. Në një datë të papërcaktuar, kërkueti depozitoi një ankesë kushtetuese. Përveç argumenteve të tij të mëparshëm, ai deklaroi se më 27 qershor 2004 nuk kishte pasur burimet e mjaftueshme për të përballuar një avokat dhe se autoritetet do të duhej t'i kishin caktuar një avokat të financuar nga shteti për ta mbrojtur.

21. Më 18 dhjetor 2007, e gjitha trupa e Gjykatës Kushtetuese e rrezoi ankesën. Gjykata vlerësoi se më 27 qershor 2004, kërkueti nuk kishte kërkuar ndihmë juridike. Nëse ai do ta kishte bërë një kërkesë të tillë, autoritetet do të kishin pasur detyrimin për të caktuar një avokat të financuar nga shteti, në përputhje me parashikimin e nenit 296 § 1 të KPP-së (shoh paragrafin 28 në vijim). Gjithashtu, gjykata theksoi se kërkueti kishte pranuar të jepte shpjegime në mungesë të një avokati, duke hequr dorë në këtë mënyrë nga e drejta e tij për ndihmë juridike.

IV. LIGJI PËRKATËS VENDAS

22. Neni 79 §§ (a) dhe (c) i Kodit Penal, në fuqi në periudhën konkrete, parashikonte se vrasja me dashje e një të mituri ose e një oficeri policie përbënte vrasje të rëndë dhe dënohej me burgim të përjetshëm dhe minimalisht me njëzet vite burgim.

23. Neni 34/a § 2 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, parashikon se autoritetet duhet t'i japin të dyshuarit “letren e të drejtave” në formë të shkruar ku gjendet informacion për të drejtat e tij ose të saj për t'u mbrojtur, duke përfshirë të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për një avokat të përzgjedhur nga vet i dyshuari ose për ndihmë juridike falas sipas disa kushteve të caktuara, përpara se të zhvillohet seanca e parë e marrjes në pyetje.

24. Neni 49 §§ 1 dhe 2 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, parashikonte:

“1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë.

2. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.”

25. Pjesa përkatëse e nenit 49 § 1 e KPP-së, në fuqi prej datës 1 gusht 2017, parashikon:

“1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:

...

ç) është akuzuar për një veprë penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;”

26. Neni 151 § 4 i KPP-së në fuqi, në periudhën përkatëse parashikonte se mbledhja e provave në mënyrë të paligjshme nuk mund të përdorej në gjykatë, dhe një përjashtim i tillë, duke përfshirë edhe vet mocionin e gjykatës, mund të bëhej në çdo moment të procesit.

27. Neni 158 § 1 i KPP-së, në fuqi në periudhën përkatëse, parashikonte:

“Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

a) individët që janë në një lidhje të afërt gjaku me të pandehurin...”.

28. Neni 296 § 1 i KPP-së, në fuqi më 1 gusht 2017, e bënte të detyrueshme praninë e një avokati gjatë marrjes në pyetje të një individi nën hetim nga një oficer i policisë gjyqësore. Në përputhje me të njëjtin parashikim, kur nuk mund të gjendet një avokat, ose kur avokati nuk ndjek marrjen në pyetje, prokurorit i kërkohet të caktojë një avokat të financuar nga shteti për të dyshuarin.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3 (c) TË KONVENTËS

29. Kërkuesi u ankua se dënimi i tij ishte mbështetur, midis të tjerash, në deklaratat e tij të datës 27 qershor 2004, që ishin marrë në mungesë të një avokati, në shkelje të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë dhe për ndihmë juridike sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.

A. Pranueshmëria

30. Kjo ankesë nuk është qartazi e pambështetur në fakte, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës ose e papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

31. Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për një avokat, për të heshtur, për privilegjin ndaj vetinkriminimit, për të hequr dorë nga e drejta për ndihmë juridike dhe për marrëdhënien e këtyre të drejtave ndaj drejtësisë së përgjithshme në proces sipas aspektit penal të nenit 6 të Konventës mund të gjenden, midis të tjerash, në vendimin *Ibrahim dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([DHM], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, §§ 249–74, 13 shtator 2016); *Simeonovi kundër Bullgarisë* ([DHM], nr. 21980/04, §§ 110–20, 12 maj 2017); dhe *Beuzë kundër Belgjikës* [DHM], nr. 71409/10, §§ 119–50, 9 nëntor 2018).

1. Nëse kërkuesi hoqi dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike

32. Gjykata ka vendosur se në mënyrë që të pretendohet për heqje dorë nga e drejta për këshillim për të respektuar standardin e “dijenisë dhe inteligjencës”, kërkuesi duhet të bëhet me dije për të drejtat e tij (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, § 272, dhe *Simeonovi*, § 115, të dy cituar më sipër).

33. Gjykata thekson se detyrimi i autoriteteve sipas ligjit vendas për t’i pajisur të pandehurit me “letrën e të drejtave”, që përmban informacione për të drejtat e tyre, duke përfshirë të drejtën e tyre për të heshtur dhe për të pasur një avokat të përzgjedhur prej tyre ose ndihmë juridike falas me përmbushjen e disa kushteve, hyri në fuqi vetëm më 1 gusht 2017 (shih paragrafin 23 më sipër). Për këtë arsye, kërkuesi nuk u pajis me “letrën e të drejtave” përpara seancës së parë të marrjes në pyetje.

34. Në vijim, Gjykata vëren se kërkuesi ishte vënë në dijeni në lidhje me nenin 158 të KPP-së (shih paragrafët 6 dhe 27 më sipër) për të drejtën e tij për të mos dëshmuar ndaj një personi me të cilin kishte lidhje, më konkretisht me kushëririn e tij E., dhe në po të njëjtën fjalë, kërkuesi ishte vënë në dijeni për të drejtën e tij “për të dhënë shpjegime ose për të mos e bërë këtë gjë” (shih paragrafin 6 më sipër). Është e dyshimtë nëse ky formulim ishte mjaftueshëm i qartë që kërkuesi të kuptonte se kishte të drejtën për të heshtur në lidhje me akuzat ndaj tij.

35. Teksa kërkuesi u informua, edhe pse në mënyrë të përmbledhur, për “të drejtën e tij për një avokat”, nuk ishte e qartë nëse bëhej fjalë për një avokat të përzgjedhur prej tij, apo për një avokat të garantuar nga autoritetet falas. Si përgjigje ndaj kësaj, kërkuesi deklaroi se ai nuk kishte një avokat dhe se do t’i kërkonte babait të tij që të siguronte një avokat më vonë (shih paragrafin 6 më sipër). Sipas këndvështrimit të Gjykatës, mbetet e dyshimtë nëse kjo përgjigje provonte zgjedhjen me dijeni të të pandehurit për të hequr dorë nga e drejta e tij për këshillim, apo nëse ajo reflektonte faktin se në praktikë ai e kishte të pamundur për të marrë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së tij në atë moment specifik.

36. Gjykata nuk anashkalon faktin se në periudhën konkrete neni 49 § 2 i KPP-së parashikonte për një përfaqësim juridik të detyrueshëm vetëm për të miturit, apo se përfaqësimi i detyrueshëm për veprat penale me një dënim minimal prej pesëmbëdhjetë vitesh hyri në fuqi vetëm më 1 gusht 2017 (shih paragrafin 25 më sipër). Në periudhën e marrjes së tij në pyetje, kërkuesi sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte arsim të kufizuar dhe asnjë eksperiencë profesionale. Ai po përballej me një dënim me njëzet vite burgim ose me burgim të përjetshëm (shih paragrafin 22 më sipër), dhe është i dyshimtë fakti nëse ai mund të parashikonte pasojat e pretendimit për heqjen dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike (shih *Simeonovi*, cituar më sipër, § 115, me referenca të tjera). Gjykata vëren se gjykata fillestare apo gjykatat në proceset e mëpasshme nuk u përfshinë me problematikat e mësipërme, pavarësisht kundërshtimeve specifike të kërkuesit në apel (shih *Rodionov kundër Rosisë*, nr. 9106/09, § 167, 11 dhjetor 2018, për detyrimin e gjykatës vendase për të shqyrtuar rrethanat në lidhje me heqjen dorë të një të pandehuri nga të drejtat e tij për mbrojtje). Në fakt, ato u mbështetën ekskluzivisht dhe pa bërë hetime të tjera në procesverbalin e datës 27 qershor 2004, dhe në faktin se ai nuk kishte kërkuar shprehimisht për një avokat pasi ishte konstatuar se ai kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike (shih, veçanërisht, paragrafin 21 më sipër).

37. Në lidhje me sa është konstatuar në paragrafin 35 më lart, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se gjykatat vendase kanë vendosur në një mënyrë bindëse nëse heqja dorë e kërkuesit për ndihmë juridike ishte bërë në mënyrë vullnetare ose jo (shih *Bozkaya kundër Turqisë*, nr. 46661/09, §§ 49–51, 5 shtator 2017). Duke qenë se kërkuesi nuk ishte informuar se ai mund t'i kërkonte autoriteteve që të siguronin një avokat për të, Gjykata nuk mundet t'i japë një peshë vendimtare faktit se ai nuk e bëri këtë kërkesë në rrethanat e çështjes.

38. Në këtë mënyrë, Gjykata vendos se e drejta e kërkuesit për ndihmë juridike ishte kufizuar.

2. Nëse ekzistonin "arsye bindëse" që justifikonin kufizimin

39. Gjykata thekson se kufizimet për të pasur një avokat për arsye bindëse, në fazën paraprake lejohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, duhet të jenë të një natyre të përkohshme dhe duhet të mbështeten në një vlerësim individual të rrethanave specifike të çështjes (shih *Simeonovi*, § 130, cituar më sipër).

40. Qeveria nuk ka provuar ekzistencën e ndonjë rrethana të jashtëzakonshme që do të justifikonte kufizimet ndaj të drejtës së kërkuesit. Rrjedhimisht, kufizimet konkrete nuk justifikoheshin mbështetur në ndonjë arsye bindëse.

3. Drejtësia e përgjithshme e procedurave

41. Në vijim, Gjykata duhet të përcaktojë nëse pavarësisht kufizimit të së drejtës së kërkuesit për një avokat, gjë që krijon prezumimin se procedurat nuk ishin të drejta sipas interpretimit të nenit 6 § 1 të Konventës (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 273, dhe *Schmid-Laffer kundër Zvicrës*, nr. 41269/08, §§ 36–40, 16 qershor 2015), ekzistonte arsyeja për të vendosur se procesi në tërësi ishte i drejtë. Përgjegjësia bie mbi qeverinë që të provojë bindshëm se përse, në mënyrë përjashtimore dhe në rrethanat specifike të çështjes, drejtësia e përgjithshme e gjykimit nuk ishte paragjykuar në mënyrë të pakthyeshme nga kufizimi i dhënies së këshillimit juridik (shih *Ibrahim dhe të Tjerë*, §§ 264–65, dhe *Simeonovi*, § 118, të dy cituar më sipër), dhe sipas parimeve të përcaktuara në vendimin *Ibrahim* (§274).

42. Qeveria nuk bëri asnjë parashtrim në lidhje me sa më sipër.

43. Tashmë Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi sapo kishte mbushur tetëmbëdhjetë vjeç dhe kishte pasur arsim të kufizuar dhe asnjë eksperiencë profesionale, gjithashtu, ajo tashmë ka konstatuar se ai nuk u informua në mënyrën e duhur për të drejtat për ndihmë juridike dhe për të heshtur (shih paragrafët 39 dhe 40 më sipër).

44. Gjithashtu, Gjykata vëren se deklarata e kërkuesit e datës 27 qershor 2004, ishte pranuar si provë përpara gjykatave vendase dhe se ishte vlerësuar prej tyre si e rëndësishme për çështjen. Gjykatat vendase konfirmuan bashkëpunimin e kërkuesit me E. kryesisht mbështetur në deklaratat dhënë nga dy të miturit, por gjithashtu ato e vlerësuan deklaratën e datës 27 qershor 2004 të rëndësishme për të vërtetuar disa zhvillime të caktuara përpara dhe pas të shtënave me armë. Në të vërtetë, Gjykata e Rrethit rezultoi se i dha shumë rëndësi faktit se kërkuesi kishte

qenë i pranishëm dhe e kishte “shoqëruar” E. në planifikimin e vrasje, si edhe përshkrimit të detajuar të kërkuarit në deklaratat e tij të datës 27 qershor 2004 të rrethanave në të cilat ai kishte kaluar kohë me E. (shih paragrafin 16 më sipër). Kërkuari kërkoi në mënyrë të vazhdueshme që deklaratat e tij të datës 27 qershor të hiqeshin nga dosja e çështjes, por gjykatat vendase e rrëzuan kërkesën e tij (shih paragrafin 13 më sipër). Kjo gjë sugjeron edhe se gjykatat vendase i konsideronin deklaratat e kërkuarit të datës 27 qershor 2004 si të rëndësishme për çështjen.

45. E drejta e kërkuarit për të mos u dënuar në mbështetje të deklaratave të tij dhënë pa ndihmë juridike nuk kufizohet në rrëfime konkrete apo në vërejtjet që janë drejtpërdrejtë inkriminuese; pasi në mënyrë që deklaratat të konsiderohen si vetëinkriminuese, është e mjaftueshme që ato të kenë ndikuar në mënyrë thelbësore në pozicionin e të akuzuarit (shih, *mutatis mutandis*, *Bjarki H. Diego kundër Islandës*, nr. 30965/17, § 58, 15 mars 2022). Në çështjen konkrete, edhe pse gjykatat kanë shqyrtuar prova të tjera të rëndësishme, qasja e autoriteteve ndaj hetimit dhe kualifikimi i veprimeve të kërkuarit janë ndikuar ndjeshëm nga deklaratat e detajuara prej tij më 27 qershor 2004, në lidhje me aktivitetet e tij me E. përpara dhe pas vrasjes, dhe në këtë mënyrë kanë përbërë një pjesë integrale të provave mbi të cilat është mbështetur dënimi (shih *Sitnevskiy dhe Chaykovskiy kundër Ukrainës*, nr. 48016/06 dhe 7817/07, § 84, 10 nëntor 2016; *Mehmet Zeki Çelebi kundër Turqisë*; nr. 27582/07, § 71, 28 janar 2020; dhe *brus kundër Belgjikës*, nr. 18779/15, § 13, 14 shtator 2021).

46. Në këtë kontekst, qeveria nuk ka demonstruar, dhe as Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin, se drejtësia e përgjithshme e procesit nuk ishte paragjykuar nga deklaratat e bëra nga kërkuari më 27 qershor 2004 në mungesë të një avokati.

47. Për këtë arsye, është shkëlur neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës.

II. ANKESAT E TJERA

48. Kërkuari u ankua edhe për faktin se mënyra me të cilën autoritetet kishin marrë në pyetje të miturit më 14 korrik 2004, dhe mënyra me të cilën ish-in vlerësuar deklaratat e tyre nga gjykatat vendase, kishte shkaktuar shkelje të kërkesës për “gjykim të drejtë” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Duke marrë në konsideratë faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe konstatimet e saj si më lartë, Gjykata vlerëson se ajo ka trajtuar pyetjet kryesore juridike të ngritura nga çështja dhe se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen ankesat e tjera (shih *Qendrën për Burime Juridike në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

NENI 41 I KONVENTËS

A. Dëmi

49. Kërkuari kërkoi 20,000 euro për dëmin jopasuror dhe nuk bëri asnjë kërkesë për dëm pasuror.

50. Qeveria parashtrroi se kërkesa ishte e tepruar.

51. Gjykata nuk mund të spekulojë për rezultatin e procesit ndaj kërkuarit nëse nuk ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës. Gjykata vlerëson se konstatimi i shkeljes përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në çështjen konkrete. Për këtë arsye, ajo e rrëzon kërkesën.

52. Megjithatë, forma më e përshtatshme e korrigjimit, në parim, do të ishte rihapja e procesit, nëse kjo gjë do të kërkohej.

B. Kostot dhe shpenzimet

53. Kërkuari kërkoi 300,000 lekë (afërsisht 2,400 euro) për kostot dhe shpenzimet e bëra gjatë procesit në gjykatat vendase, dhe 3,710 euro për kostot e bëra në Gjykatë. Përfaqësuesi i tij paraqiti dy fatura të detajuara të nënshkruara prej tij dhe deklaroi se për shkak të rrethanave të vështira financiare të kërkuarit, ai nuk i kishte kërkuar kërkuarit të bënte parapagesë (shih paragrafin 10 më sipër).

54. Qeveria i kundërshtoi të dyja kërkesat.

55. Për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse të nënshkruara nga kërkuari dhe duke treguar se ai kishte ndërmarrë detyrimin për të paguar avokatin e tij, për këtë pjesë nuk u bë asnjë akordim.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. E deklaron kërkesën të pranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës;
3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme që të shqyrtohen meritat e ankesave të tjera;
4. *Rrezon* pretendimin e kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 14 nëntor 2023, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

KRYETAR
Georgios A. Serghides

ZËVENDËSSEKRETARE
Olga Chernishova